



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 65/2016

Prishtinë, më 19.7.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala dhe Blerim Grainca, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës i ftuar: Kreshnik Gashi, kryetar i Bordit i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare –ARKEP.

Pjesëmarrës të tjerë: Ilir Ymeri, Rrezarta Ajeti dhe Nazm Rahimi - ARKEP; Agnesa Haxhiu – KDI; Dardan Abazi – INDEP; Dren Ajeti- GLPS; Florina Ujupi - BIRN dhe Mjellma Kadriu, praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Donika Lushaku - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 4.7.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 4.7.2016;

Raif Qela, kërkoi që të shtohen disa plotësime dhe deklarime lidhur me amendamentet e Projektligjit për Rregullat e Komunikacionit Rrugor, për arsye që kjo ndihmon debatin, i cili do të zhvillohet në seancën plenare, që të sqarohen çështjet të cilat i kemi pasur kontestuese.

Kryetari, kërkoi nga z. Qela që këto deklarime t'ia dërgojë me shkrim stafit dhe të plotësohet procesverbali.

Procesverbali nga mbledhja e datës 4.7.2016 , u miratua më plotësimet e z. Qela.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015;

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha Komisioni e ka pranuar më kohë Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP për vitin 2015 dhe më pas fjalën ia kaloi z.Kreshnik Gashi, kryetar i Bordit, që të paraqes raportin në disa pika kyçe për punën dhe aktivitetin e ARKEP- it.

Kreshnik Gashi, kryetar i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP, në mënyre kronologjike e paraqiti punë dhe gjitha aktivitetet e zhvilluara të ARKEP -it në zbatim të Ligjit për Komunikimet Elektronike dhe Ligjit për Shërbimet Postare Nr. 03/L-185 , raportin e rregullt vjetor të veprimtarisë për vitin 2015 të shoqëruar me raportin financiar, për informim, shqyrtim dhe miratim. Raporti përmban një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore teknike e komerciale për aktivitetet e rregulluara në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës. Raporti po ashtu përmban edhe raportin financiar (pika 9) të ARKEP-it, për vitin 2015, së bashku me raportin e Auditorit (pika 10). Viti 2015 ka shënuar një varg arritjesh për ARKEP-in, si autoritet rregullator i dy fushave me rëndësi për zhvillimin e ekonomik të vendit. Gjatë vitit 2015, ARKEP-i: ka miratuar dhënien e blloqeve shtesë frekuencore në kuadër të brezit 1800 MHZ, për operatorët Telekom i Kosovës SH.A. dhe IPKO Telecommunications LLC, për ofrimin e shërbimeve mobile brezgjëra, aktivitet i cili ka shënuar sigurisht një nga ngjarjet më me rëndësi në fushën e telekomit, që i ka hapur rrugë mundësisë së zgjerimi të rrjetit të dy operatorëve të telefonisë mobile, të cilët janë gjeneruesit kryesor të të hyrave në tregun e telekomit në Kosovë; ka iniciuar dhe përmbyllur 2 (dy) procese të këshillimeve publike me palët e interesit, respektivisht për dy draft- rregullore: draft- rregullorja për kontratat, transparencën dhe publikimin e informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundorë për ofrimin e rrjetave dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike; Draft- Rregullorja për standardet teknike dhe organizative për sigurinë dhe integritetin e rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike; ka administruar 5

procese të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në mes ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike; ka përmbyllur dhe miratuar vendimin final për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për interkoneksionin në mes operatorëve: Kujtesa.Net Sh.P.K dhe IPKO Telecommunications LLC; Ka iniciuar dhe përmbyllur procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjen në mes të Telekomit të Kosovës dhe IPKO Telecommunications, lidhur me interkoneksionin në mes numrave 5x; ka iniciuar dhe përmbyllur procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjen në mes Telekomit të Kosovës dhe IPKO Telecommunications lidhur me interkoneksionin në rrjetat mobile, respektivisht zvogëlimin e tarifave të terminimit (MTR); ka iniciuar dhe përmbyllur procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjen në mes Telekomit të Kosovës dhe IPKO Telecommunications, lidhur me interkoneksionin në rrjetet fikse, respektivisht zvogëlimin e tarifave të terminimit (FTR); ka iniciuar dhe përmbyllur procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes si dhe ka miratuar tarifën për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës pasive (shtyllave) të komunikimeve elektronike në mes operatorëve: Telekomit të Kosovës SH.A. IPKO Telecommunications LLC dhe Kujtesa.Net Sh.P.K.; ka miratuar tarifat për tregjet në të cilat Telekomit të Kosovës SH.A. është përcaktuar si kompani me fuqi të ndjeshme: Tregjet me pakicë (3 tregje); Tarifat e qasjes dhe thirrjeve (kombëtare dhe ndërkombëtare) në rrjetin publik telefonik fikse; Tarifat për ofrimin e qasjes me shumicë (ËLR) në rrjetin publik telefonik fikse, Oferta referente për qasjen me shumicë në infrastrukturën e rrjetave fizike (përfshirë qasjen e plotë, të pjesshme dhe të ndarë) për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike (RUO). Kushtet e përgjithshme të kontratës standarde për kyçe në shërbime të Telekomit të Kosovës SH.A. – Telefonia fikse; ka miratuar tarifat për licencim për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve postare (*one-off*) si dhe tarifave vjetore; Ka miratuar tarifat (çmimore) për ofrimin e shërbimeve universale postare; ka nxjerr një numër të konsiderueshëm të interpretimeve dhe/apo udhëzime për palët; ka autorizuar gjithsej 9 (nëntë) ofrues të rinj për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike me gjithsej 20 aktivitete, prej tyre 8 (tetë) aktivitete të ofrimit të rrjetit publik fikse, 2 (dy) aktivitete të ofrimit të shërbimeve publike fikse, 8 (tetë) aktivitete të ofrimit të shërbimeve të internetit, 1 (një) aktivitet të ofrimit të linjave me qira dhe 1 (një) aktivitet të ofrimit të shërbimeve me vlerë të shtuar; ka pranuar dhe marrë në shqyrtim 46 (dyzetegjashtë) raste të ankesave të konsumatorëve në/dhe ndërlidhur me shërbimet e komunikimeve elektronike si dhe 6 (gjashtë) raste të ankesës së konsumatorëve ndërlidhur me shërbimet postare, duke i përmbyllur dhe zgjidhur ato përmes dhënies së interpretimeve, udhëzimeve dhe rekomandimeve (*memove* sqaruese), të paraqitura ndaj konsumatorëve dhe operatorëve, në rastet kur konsumatorët nuk kanë konsumuar procedurat në shkallë të parë pranë/me operatorin ofrues i shërbimeve; janë nxjerr gjithsej 187 autorizime individuale për përdorim të resurseve frekuencore, respektivisht 2,253 kanaleve frekuencore dhe 6 blloqeve frekuencore; janë nxjerr gjithsej 113 Vendime për caktimin/rezervimin e resurseve numeriken respektivisht 102,158 numra jogeografik dhe gjeografik, shumica prej të cilëve për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile; janë realizuar gjithsej 184 matje në terren nga ekipi i Radio Monitorimit, për të verifikuar përmbushjen e obligimeve që kanë shfrytëzuesit e resurseve frekuencore si dhe evidentimin e shfrytëzimit të pa autorizuar. Autoriteti në kuadër të objektivit për ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve teknike për menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve frekuencore, pas implementimit të projektit për blerjen e pajisjeve të sofistikuar (në vitin 2014), gjatë vitit 2015, ka filluar me monitorimin e shërbimeve të reja të ofruara përmes teknologjive 3G dhe 4 G (LTE); Gjatë tërë vitit 2015 përmes platformës së ARKEP, janë realizuar matje në gjithsej 16 komuna të Republikës së Kosovës, për parametrat e kualitetit të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike: shërbimet e telefonisë mobile dhe fikse; janë administruar gjithsej 23 (njëzetetre) masa

ndëshkuese duke përfshirë shërbime postare (3 masa ndëshkuese), në vlerë totale me pagesat e vonesës administrative prej 11,806.97 €; Janë realizuar inspektive të rregullta në ndërmarrjet, të cilat ofrojnë shërbime publike të komunikimeve elektronike si dhe 8 (tetë) inspektive tek ofruesit e shërbimeve postare. Janë shqyrtuar gjithsej 3 (tri) aplikacione për njohje të konformitetit të radio pajisjeve dhe pajisjeve terminale telekomunikuese nga ndërmarrje të ndryshme. Autoriteti ka vazhduar me intensitet të shtuar koordinimin, pjesëmarrjen dhe dhënien e kontributit të tij profesional, në procesin e dialogut teknik në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, lidhur me temën e telekomunikacionit, respektivisht arritjes së marrëveshjes për planin aksional në arritjen e marrëveshjes së vitit 2013; Është draftuar rregullorja për operimin e regjistrimit të ccTLD si dhe Raporti për kodin e Internetit ccTLD dhe gTLD; Është vazhduar puna me avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit, si atyre të angazhuar në rregullimin e tregut ashtu edhe në stafin mbështetës (administrativ) për të siguruar punë efektive, duke mbajtur në fokus angazhimin drejt ndërtimit të një kuadri me staf profesional dhe të përgjegjshëm; 280 ditë efektive trajnimi dhe/apo pjesëmarrje në punëtori, konferenca apo vizita studimore, në total të realizuara gjatë vitit 2015. Gjithashtu, gjatë vitit 2015, zyrtarët përgjegjës për përgatitjen dhe funksionalizimin e Qendrës Nacionale, referuar si Qendra Kompjuterike dhe Reagime Emergjente (CERT), kanë realizuar vizita me përkrahjen e projektit të Bashkimit Evropian. Ai tha që janë realizuar të hyra mbi 19 milionë euro, respektivisht 19,278,767.86 euro, prej të cilave të ndara sipas kategorive të të hyrave. Ai theksoi se është përafruar dhe rrumbullakuar korniza e akteve rregullatore, të gjitha të harmonizuara me pakon rregullatore të Bashkimit Evropian, (*EU Regulatory Framework 2003-2009*), pako e transpozuar në Ligjin për Komunikime Elektronike. Sa i përket pasqyrës së tregut të komunikimeve elektronike, numri i përdoruesve aktivë të telefonisë mobile në fund të vitit 2015, arriti në mbi 1,77 milion, krahasuar me 1,73 milion sa ishte në fund të vitit 2014, gjersa numri i përdoruesve të shërbimeve të internetit (qasje fikse) në fund të vitit 2015, arriti në 215,788 përdorues, gjersa në fund të vitit 2014 ka qenë 190,802 (rritje prej 4%). Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në fund të vitit 2015 në segmentin e telefonisë mobile ishte 97.7% , rahasuar me 95.36% , në fund të vitit 2014, ku numri i përdoruesve me qasje brezgjërë (*broadband*) 3G dhe 4G, në pajisjet mobile të mençura (smart phone) ka arritur në 711,648 përdorues, nga 283,989 përdorues (rritje prej 151%) sa ishin në fund vitin 2014. Në shërbimet e ofruara nga rrjetet fikse, qasja broadband në Internet shënoi rritje të ndjeshme (me 13.1%) ndërsa numri i përdoruesve të telefonisë fikse si edhe në vitet paraprake shënoi rënie për 5.43%. Nga të dhënat e Autoritetit, vërejmë se rrjetet fikse dhe mobile kanë pasur zgjerim dhe zhvillim të konsiderueshëm gjatë vitit 2015 ku vetëm në rrjetet mobile dhe fikse janë regjistruar rreth 40 milionë euro investime të reja dhe se zgjerimi i rrjeteve ka ndodh në dy kahe. Tarifat e shërbimeve mobile krahasuar me vitin paraprak, rezultojnë me tendencë të reduktimit të tyre, ku nga krahasimet vërehet se reduktimet të ndjeshme janë bërë nga ana e operatorëve në ofertat tarifore për gjitha shportat e konsumit (konsumit të lartë, atë mesatar dhe atë të ultë). Niveli mesatar i shpenzimeve për shportat OECD, rezulton të jetë në vlerë prej 10.91 €. Të hyrat nga shërbimet telekomunikuese, për vitin 2015 kapin shumën prej 173,788,107€, që në krahasim me vitin 2014 del që të hyrat nga sektori kanë shënuar rënie prej 9.6%. Operatorët e telefonisë mobile dhe ofruesit e shërbimeve të internetit zotërojnë pjesën më të madhe të tregut të komunikimeve elektronike me rreth 82% të të ardhurave. Vetëm të hyrat e operatorëve mobilë përbëjnë rreth 70% të të ardhurave të gjithë tregut, duke u përcjell nga ofruesit e shërbimeve të internetit me 11.81%, televizioni kabllor 11.63%, ndërsa operatorët fiks zotërojnë rreth 5.91%. Kjo rënie në tregun e telefonisë mobile dhe fikse kryesisht vjen si rezultat i konkurrencës në rritje të shërbimeve dhe

garës për konsumator si dhe për shkak të zhvillimeve teknologjike dhe përdorimit në rritje të aplikacioneve të ashtuquajtura ‘*Over the Top*’ (OTT), të cilat përdoren në telefonat e mençur me qasje në internet. Ndërsa rënia e të hyrave nga tregu i linjave me qira konsiston në zhvillimin dhe shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike, respektivisht rritjen e konkurrencës në nivel të rrjeteve pothuajse në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Sa i përket shërbimeve postare, gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014, kemi një rritje të theksuar të numrit të përgjithshëm të dërgesave – artikujve postare në përgjithësi, dhe atë në vlerën prej; 32.62 %, përderisa NPQ “Posta Kosovës SHA”, ka një rritje të theksuar të volumit të përgjithshëm të dërgesave postare në vlerën prej 49.44 %, ndërsa operatorët privatë kanë një rënie të theksuar në vlerën prej; 60.01 %. Edhe përkundër trendëve në rënie të postës së letrave si në trafikun vendor ashtu edhe atë ndërkombëtar, kemi rritje të trendëve të postës së pakove, kolipostës dhe Postës Direkt. Po ashtu, në vitin 2015, krahasuar me vitin tjetër, sektori i shërbimeve postare në totalin e të hyrave ka regjistruar rritje të të hyrave të përgjithshme, në masën prej; 12.07 %, përderisa NPQ “Posta e Kosovës SHA”, ka pasur një rritje në masën prej; 10.39 %, ndërsa operatorët privatë kanë një rritje prej; 13.35 %. Sfidat, me të cilat ballafaqohet Autoriteti janë paraqitur si në vijim; Pavarësia dhe kapacitetet e ARKEP-së, referuar mungesës së pavarësisë financiare, të ndikuar nga interpretimi i kufizuar i LMF-së respektivisht procedurave dhe miratimit të buxhetit. Rritja dhe ruajtja e resurseve profesionale/nëpunësve të ARKEP-së është një nga sfida me të cilën jemi ballafaquar që nga themelimi i institucionit.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, e falënderoi z. Gashi për paraqitjen Raportit, i cili na ofroi informata të mira dhe të detajuara. Mustafa tha se Bordi i ARKEP-së pasiqë është zgjedhur ka pas mjaftë aktivitete në mënyre intensive në marrjen e vendimeve. Ai theksoi së në bazë të raportit të vitit 2015, shihet se ka pas mjaft vështirësi në telefonin fikse dhe atë mobile, për shkak të teknologjisë së avancuar. Prandaj, rregullatori, Qeveria dhe Kuvendi duhet të keni përgjegjësi në politikat e zhvillimit të operatorit publik në këtë rast siç është PTK-ja, pasiqë është ndërmarrje publike, në mënyre që t’i rris shërbimet publike tjera e te internetit, siç janë shërbimet kabllore. Këto sfida që i keni përmend ju janë shumë të rëndësishme dhe i keni cek apo kanë të bëjnë me juve, por në përgjithësi pavarësia buxhetore. Ne e kemi të njëjtin problem edhe me ZRRE-në. Disa që krijojnë të ardhura, të cilat duhet të zgjidhen në mënyrë sistimore, për të gjithë njëjtë, për arsye se Ligji i Financave Publike tash për tash e ka një standard dhe na duhet të shohim këtë çështje. Meqenëse kjo po ceket edhe në këto raportet e progresit, duhet të zgjidhet dhe se tash për tash e kemi këtë zgjedhje.

Raif Qela, tha si në vitet e kaluara e edhe sivjet raporti i ARKEP-së është i kompletuar, gjithëpërfshirës, i detajuar dhe si i tillë për mua nuk ka vërejtje. Një vërejtje tepër e vogël, tepër periferike është se një tabelë, diku në faqen 33, duhet ta ketë titullin ndryshe. Se është thirrjet sipas operatorëve. Dhe duhet në bazë të asaj që ju keni bërë këtu platforma e ARKEP-së për matjen e parametrave. Kemi bërë matje të parametrave dhe e keni quajtur thirrjet e operatorëve. Dhe kjo nuk është e saktë. Por për punën e ARKEP-së kam disa pyetje. E theksuat se në përgjithësi në fushën e telekomunikimeve elektronike ka rënie të të hyrave, dhe ka rënie një pjesë të madhe të shërbimeve të telefonisë mobile. Kjo edhe për shkak të aplikacioneve pa pagesë përmes internetit që ju i keni quajtur ashtu siç duhet quajtur On the Top shërbime, shërbime On the Top. Por, kjo nuk është e tëra, ju e thatë në raportin tuaj se rënia e të hyrave tjera ka ndikuar përveç ndikimit të konkurrencës edhe në On the Top shërbime. Neve na intereson më së shumti se sa kanë ndikuar këto të hyra nga puna e vet Rregullatorit, ngase

mendoj se për disa muaj Rregullatori është vonuar në dhënien e frekuencave, kapaciteteve frekuencore shtesë. Përderisa operatorët kanë qenë të gatshëm më heret t'i fillojnë këto shërbime edhe ka pasur një mungesë të theksuar për shkak të mungesës së frekuencave. Kanë qenë shërbime shumë të ngadalshme dhe tepër të lodhshme për secilin që i ka përdorur. Më thoni se sa e konsideroni se është kjo vonesë e dhënies së frekuencave shtesë 1800 MHz. Ndërsa, e përmendët ndër tjera edhe pavarësinë financiare. Mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet sidoqoftë sepse është Rregullator i cili duhet të ketë të hyra të vetat vetjake, sado që nuk pajtohem me konstatimin tuaj se në përgjithësi duhet të keni numër më të madh, nuk e thatë drejtpërdrejt e jo tërthorazi të ketë numër më të madh të punonjësve sepse pjesa më e madhe e operatorëve në rajon janë me numër shumë më të madh të shfrytëzuesve dhe rrjedhimisht ka edhe më shumë nevojë për punonjës sesa në Kosovë, megjithëse në raport me Malin e Zi shihet se jemi më keq.

Sala Berisha- Shala, tha se e përcolli me vëmendje raportimin. Të gjitha pyetjet pothuajse u përfshinë në shqetësimet në kuadër të asaj që i tha edhe kryetari i komisionit edhe z. Qela. Sidoqoftë, unë kam një pyetje konkrete. E përmendët që brenda vitit 2015 keni 46 raste të ankesave të qytetarëve ndaj operatorëve, janë 23 masa ndëshkuese, 3 masa ndëshkuese janë nga shërbimet postare. Këto rastet e ankesave në drejtim të cilit operatorë vinë dhe a janë këto raste që i keni shqyrtua 46 raste të ankesave apo ka më shumë ankesa që kanë mbetur të pashqyrtuara. Në kuadër të sfidave përmendet edhe pavarësinë financiare buxhetore. Në këtë fenomen e kemi edhe në agjencitë tjera të pavarura që i përgjigjen Kuvendit të Kosovës, mirëpo, Ligji për Financat Publike është i tillë dhe besoj që më në detaje me këtë çështje do ta bëjmë një zgjidhje. E përmendët se e keni numrin më të vogël të punësuarve në rajon. Pyetja ime është se a keni konstatua që keni nevojë ti shtoni kapacitet njerëzore apo vetëm se ju duket se të tjerët në rajon kanë më shumë të punësuar. Sepse nganjëherë është institucion i rëndësishëm dhe sjell të hyra buxhetore.

Blerim Grainca, i ngriti tri çështje: çështjen e vetëfinancimit, operimi ilegal dhe çështjen e Z-mobile. Për çështjen e operimit ilegal të telefonisë mobile që vepron në veri të Kosovës, jo vetëm e keni konstatuar gjendjen në raportin e ARKEP-së për vitin 2015, por deri më tani nuk e keni ndërmarr asnjë veprim. Për çështjen e Z-Mobile nuk e keni paraqitur të hyrat as trendin e rënies. Edhe për çështjen e vetëfinancimit, si e keni menduar ta bëni këtë zgjedhje pasi që Ligji për Menaxhimin e Financave Publike nuk e lejon një gjë të tillë.

Besim Beqaj, tha se lidhur me rënien e të hyrave në telefoninë mobile dhe fikse, kjo është në tërë botën, pasi kemi një teknologji në rrije shumë e përparuar. Kërkoj që ta keni një shpjegim se cilët hapa janë marrë për operimin e operatorëve ilegalë që veprojnë në veri në Kosovës. A keni mundësi të pengimit të frekuencave në brezat kufitar. Për çështjen e kodit telefonik, ju si ARKEP, i keni bërë të gjitha përgatitjet. Tani, a jeni të gatshëm për zbatimin e këtij procesi dhe cili do të jetë statusi i telefonisë së Serbisë? A kanë aplikuar për licencë ende apo a jo? Lidhur me ankesat e konsumatorëve, propozoj që do të bëhet një veprim periodik në terren, duke bërë matjen e kualitetit të internetit.

Raif Qela, pyeti se a ka vlerësim në të dhëna numerike për mungesën e kodit telefonik se sa i kushton humbje ekonomike buxhetit të Kosovës?

Kreshnik Gashi, kryetar i bordit i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, iu përgjigj pyetjeve të parashtruara nga ana e deputeteve si në vijim: Për rënien e telefonisë fikse dhe mobile, tha që është saktë që ekziston një trend i rënies në të gjitha shtetet e rajonit dhe të botës, siç u cek, për shkak të teknologjisë mjaftë të avancuar. Për çështjen e konkurrencës në TV kabllore, tha që ka dominim nga njeri nga operatorët që e ofron këtë shërbim, por kjo është konkurrenca që po ofrohet, kjo çështje është kompetencë e Komisionit të Pavarur për Media (KPM), se si i rregullon më anë të licencave këto çështje. Për vonesën e dhënës së frekuencave operatorëve, tha që operatorët kanë aplikuar në vitin 2014 për ndarjen e frekuencave, ndërsa frekuencat janë ndarë në vitin 2015, ka pas vonesa, por jo shumë së dy tre muaj në dhënien e frekuencave shtesë të telefonisë mobile. Për pavarësinë buxhetore, tha që ekzistojnë disa modele të financimit të rregullatorëve, prandaj kërkesa e jonë është që më të hyrat që ka ARKEP-ja të menaxhojmë në më një pjesë prej tyre, pasi që ARKPEP-së i është ndarë një buxhet shumë i vogël më krahasim më kërkesat dhe nevojat që i ka sidomos në rritjen e kapaciteteve në punësim. Për humbjet që shkaktohen nga mungesa e kodit telefonik shtetëror, tha që ARKEP-ja ka bërë disa analiza për humbjet që i shkathon buxhetit të shtetit mungesa e kodit telefonik shtetëror, por kjo çështje tani më është problem politik. Kemi të dhëna nga operatorët që këto humbje janë të mëdha, rreth 220 milionë euro në vit. Për të punësuarit, tha që kemi nevojë për numër më të madh të të punësuarave, sidomos për “Qëndron Emergjente Kompjuterike”, kurse për operatorët ilegalë, tha që kjo është ndërlidhur edhe me marrëveshjen që është nënshkruar në mese të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, ku parashihet që operatorët e telefonisë mobile ilegale që veprojnë, sidomos në veri të Kosovës, të mbyllen, mirëpo kjo marrëveshje ende nuk është duke u zbatuar. Për Z-mobile, tha që kjo është një marrëveshje komerciale në mese PTK-së dhe operatorit që e menaxhon, kurse për brezin e frekuencave, tha që kemi tri marrëveshje më shtetet e rajonit, me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, që mos ta pengojmë njëri-tjetrin me frekuenca.

Rrezarta Ajeti (ARKEP), ju përgjigj pyetjes për numërime e ankesave të konsumatorëve, tha që kemi ankesa nga një numër i vogël i konsumatorëve, ankesat janë për operatorin “IPKO” lidhur më shërbimet dhe kualitetin dobët të internetit. ARKEP-ja ka shqiptuar dy dënime për operatorin “IPKO” dhe një për operatorin “KUJTESA”, kur kemi ankesa neve duhet të dalim në terren për të bërë matjen e kualitetit të internetit dhe deri më tani të gjitha ankesat janë zgjidhur.

Raif Qela, tha që nuk mori përgjigje për vonesën e brezit frekuencave, pse është vonuar për operatorët dhënia brezit të frekuencave?

Ilir Ymeri (ARKEP), iu përgjigj pyetjes lidhur më vonesat e dhënies së brezit frekuencor, duke thënë në që për mënyrën e dhënies së frekuencave direkt, nuk ka metodologji unike dhe ARKEP-ja në këtë rast ka vepruar në bazë të Ligjit dhe nuk është vonuar në këtë rast.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Raporti vjetor për vitin 2015, i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), me rekomandimet, si vijon:

1. Qeveria e Kosovës, ARKEP dhe Telekomunikimet e Kosovës – Vala, duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për konsolidimin e mëtejshëm të operatorit publik, në fushën e zgjerimit të produkteve dhe shërbimeve, në harmoni me zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në strukturën e tregut;
2. ARKEP-ja dhe Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës, duhet të shqyrtojnë strukturën e tregut e të produkteve tek operatorët, për të siguruar konkurrencë të barabartë dhe për të evituar pabarazitë eventuale në segmente të caktuara të tregut të ndërlidhur (telefoni mobil, TV kabllor dhe internet);
3. ARKEP-ja, të punojë një platformë dhe të sigurojë zbatimin e masave të nevojshme teknike dhe menaxheriale për matjen e standardeve të cilësisë së shërbimeve të operatorëve ndaj konsumatorëve në komunikimet elektronike e postare;
4. ARKEP-ja, në bashkëpunim me institucionet e tjera, duhet të ndërmarrë gjithë masat e nevojshme për evitimin e prezencës së operatorëve pa licencë në tregun e Kosovës;
5. Të kërkohet, në mënyrë efektive, zbatimi i marrëveshjes së arritur në Bruksel, lidhur me kodin (prefiksin) postar të Kosovës.

4. Të ndryshme Çështjet vijuese.

a) Projektligji për Trepçën

Raif Qela, pyeti a ka përgjigje nga ana e Qeverisë lidhur me informatën e që e ka kërkuar lidhur me çështjen e Projektligjit për Trepçën.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha që janë njoftuar përmes e-mailit nga Qeveria se janë duke punuar ende në draftin e Projektligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa